



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 34 , datë 18.1.2017

P Ë R

**PROCEDURAT E REGJISTRIMIT, TË ORGANIZIMIT
DHE KLASIFIKIMIT TË VEPRAVE TË TË DREJTAVE TË AUTORIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18, të ligjit nr.35/2016, "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. PROCEDURAT E REGJISTRIMIT TË TË DREJTAVE TË AUTORIT

1. Procedurat e regjistrimit dhe të pajisjes me certifikatë të të drejtave të autorit kryhen nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit (DDA) pranë ministrisë përgjegjëse për të drejtat e autorit.
2. DDA-ja shqyrton dhe regjistron çdo aplikim për regjistrim të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, për subjektin aplikues, autor apo mbajtës/titullar i të drejtave të autorit mbi një vepër.
3. Regjistri i të drejtave të autorit është elektronik dhe dokumentar, i krijuar për të mbajtur të dhënat e të gjitha aplikimeve, regjistrimeve, depozitave, pajisjeve me certifikata dhe të çdo veprimi të ndërmarrë nga DDA-ja.
4. Administrimi i regjistrimit të të drejtave të autorit bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore. Rregulloret për organizimin e funksionimin e brendshëm të tij miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për të drejtat e autorit.

5. Regjistri dhe çdo informacion ruhen dhe administrohen nga DDA-ja, në përputhje me ligjin nr.10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore", ligjin nr.9154, datë 16.11.2003, "Për arkivat", dhe u vihen në dispozicion palëve të interesuara, në përputhje me ligjin nr.119/2014, "Për të drejtën e informimit".
6. Regjistri i të drejtave të autorit është i organizuar në klasa administrative dhe organizohet (indeksohet) në bazë të qëllimit dhe aplikimit në DDA, në përputhje me ligjin nr.10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore".
7. DDA-ja, nëpërmjet strukturës përgjegjëse, vë në dispozicion të aplikantëve/ subjekteve të interesuara, pa pagesë, formularët-tip të aplikimit. Këta formularë miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për të drejtat e autorit, në përputhje me klasën administrative, sipas qëllimit të aplikimit nga subjekti.
8. Çdo aplikant/subjekt duhet të paraqesë:
 - a) formularin-tip, ku kërkohet regjistrimi/pajisja me certifikatë e të drejtave të autorit (e cila do të ketë të dhëna standarde: emër, mbiemër, data e aplikimit, titulli i veprës dhe kategoria e veprës etj);
 - b) deklaratë me shkrim, përpara nëpunësit civil të ngarkuar me regjistrimin e të drejtave të autorit, ku autori deklaron, në përgjegjësinë e tij, se ai është autori, krijuesi për veprën ose bashkëautor, në rast se ka më shumë se një autor;
 - c) fotokopje pasaporte ose ID;
 - ç) mandatin e pagesën për regjistrim të të drejtave të autorit;
 - d) kopje të veprës në formë të shkruar ose CD, e cila duhet të jetë sa më e detajuar për mbrojtjen e të drejtave të autorit krijues;
 dh) çdo dokument tjetër shtesë, të nevojshëm për vërtetimin e të drejtave, objekt regjistrimi.
9. Tarifa për regjistrimin e veprës është e përcaktuar sipas tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit.
10. DDA-ja depoziton të gjitha aplikimet, regjistrimet dhe ndryshimet e të drejtave të autorit, të cilat i mban në bazën e të dhënave që administrohen në Regjistrin e të Drejtave të Autorit.
11. Procedura e regjistrimit pranë DDA-së zgjat në një afat maksimal prej 45 ditësh. Konkretisht, kjo procedurë përfshin:
 - a) paraqitjen e kërkesës për regjistrim;
 - b) shqyrtimin e kërkesës (30 ditë);

- c) regjistrimin e veprës të së drejtës së autorit (5 ditë);
ç) pajisjen me certifikatë nga ana e DDA-së (10 ditë).
12. DDA-ja vendos pullën artistike të saj, të pakonsumuar, dhe depoziton një kopje origjinale të mbajtësit fonografik/videogramit të veprës ose të mjetit të ngjashëm me të, për riprodhimin e saj.
 13. Aplikanti (autori/ët, përfaqësuesit e tyre ligjorë, trashëgimtarët, titullarët e të drejtave të tyre apo agjencitë e administrimit kolektiv) plotëson formularin përkatës dhe ia paraqet DDA-së, të shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm, në përputhje me kërkesat e ligjit nr.35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, dhe rregulloren e brendshme të ministrisë përgjegjëse për të drejtat e autorit, si dhe çdo informacion tjetër të vlerësuar nga DDA-ja, të vlefshëm për veprën dhe të drejtat mbi të.
 14. Certifikata e lëshuar për regjistrimin e të drejtave të autorit dëshmon regjistrimin e një të drejte autori, që gëzon mbrojtje, në zbatim të ligjit nr.35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, por nuk provon autorësinë e saj.
 15. Pajisja me certifikatë bëhet nga struktura përgjegjëse e DDA-së dhe nënshkruhet nga drejtori i saj për titullarët e regjistruar të të drejtave të autorit, që dëshmojnë ndaj të tretëve të drejtat e tyre të regjistruara.
 16. Certifikata përmban të dhënat e deklaruara në aplikim, së bashku me numrin dhe datën e regjistrimit, sipas formatit të miratuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për të drejtat e autorit.
 17. Data e regjistrimit të të drejtave të autorit është data kur aplikimi dhe tarifa janë depozituar për regjistrim në DDA.
 18. Vendosja e pullës artistike nga DDA-ja është një akt i domosdoshëm. Çdo prodhim i kopjes private duhet të ketë identifikimin e prodhuesit, me shenjën e tij mbrojtëse “P”, të deklaruar pranë DDA-së. Botuesi/prodhuesi i kopjes private, për çdo prodhim/riprodhim, duhet të jetë i pajisur me autorizim nga mbajtësi/titullari/ët e të drejtave të autorit ose agjencitë e administrimit kolektiv. Po ashtu, çdo prodhim ose çdo kopje private, që hyn nga jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, duhet të pajiset me pullën e DDA-së. Kjo pullë duhet të ketë të gjitha elementet e sigurisë, bazuar në numrin serial dhe logon e integruar brenda pullës së prodhuar. Pulla mund të përmbajë edhe çdo element tjetër që rrit origjinalitetin e saj,

